



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. regjistri 30/2020 (JR)
Datë 22.07.2020

Vendim nr. 1 (JR)
Datë 17.01.2023

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 17.01.2023, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Andi Civici, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 243, datë 04.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ligji ndryshues nr. 76/2016, datë 22.07.2016, neni 63 e vijues i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, i cili nëpërmjet ankimit kërkoi ndryshimin e

vendimit nr. 243, datë 04.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe konfirmimin në detyrë, ndërsa nëpërmjet parashtimeve të datës 13.10.2022, kërkoi kalimin e çështjes në seancë publike, riçeljen e hetimit dhe administrimin e provave të reja, prishjen e këtij vendimi dhe urdhërimin e Komisionit të kryejë procesin e rivlerësimit edhe për kriteret e figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Andi Civici, në momentin e ndryshimeve kushtetuese që sollën procesin e rivlerësimit, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë (në vijim “GjAT”). Ai i është nënshtuar procesit të rivlerësimit nga Komisioni *ex officio*, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës.
2. Pas administrimit të raporteve të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas parashikimeve të neneve 33, 39 e 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 243, datë 04.03.2020, Komisioni vendosi *shkarkimin nga detyra* të subjektit të rivlerësimit Andi Civici, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Vendimi për subjektin e rivlerësimit është marrë nga Komisioni bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë. Komisioni konkludoi se:
 - 3.1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, në cilësinë e huadhënësve, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament banimi në qytetin e Vlorës në vitin 2003. Ky apartament ka shërbyer si një ndër burimet e deklaruara për blerjen e apartamentit të ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, në vlerën 155.000 euro, fituar me kontratën noteriale të shitjes që mban datën 01.10.2012.
 - 3.2. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të bindë Komisionin lidhur me vërtetësinë e çmimit të transaksionit financiar për shitjen e apartamentit në qytetin e Vlorës, z. E. K., në vitin 2011. Ky transaksion, sipas deklaramit të subjektit, ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të sipërcituar në rr. “{***}”, Tiranë.

3.3. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një balancë negative në shumën (-) 879.551 lekë, pa përfshirë rezultatin e hetimit lidhur me apartamentin në Tiranë dhe burimin për krijimin e asaj pasurie ndër vite.

III. Shkaqet e ankimit

4. Në datën 29.05.2020, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi nr. 243, datë 04.03.2020, i Komisionit është marrë në shkelje të rënda të ligjit procedural, të cilat e bëjnë atë të cenueshëm nga organet më të larta të kontrollit, siç është Kolegji, dhe se ky vendim është dhënë në kundërshtim me parimet e gjyqimit dhe krijimit të bindjes së brendshme, e cila duhet të burojë vetëm nga provat, dhe në kundërshtim me parimet bazë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”). Së fundmi, në ankim, subjekti i rivlerësimit kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përfundimin e hetimit edhe për dy kriteret e tjera, si dhe konfirmimin e tij në detyrë.

4.1. Argumentet e subjektit të rivlerësimit për aspektet që lidhen me procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur fokusohen në: (i) mohim të drejtësisë meqenëse komisionerët nuk ka punuar në organet e drejtësisë; (ii) një prej anëtareve të trupit gjykues në Komision, znj. Xhensila Pine, gjendej në kushtet e papajtueshmërisë për shkak të qenies në një klasë në gjimnaz dhe në klasë paralele në shkollë të lartë me subjektin e rivlerësimit. Dorëheqja e paraqitur në datën 04.12.2019, vonë në proces, është e “pamotivuar”, meqenëse është bazuar mbi faktin që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është e punësuar në fondacionin që ka themeluar shkollën ku studiojnë fëmijët e komisioneres; (iii) Komisioni i ka dërguar pyetje në situata të jashtëzakonshme [tërmeti i vitit 2019], duke mos i lënë kohën e mjaftueshme për kthimin e përgjigjeve; (iv) nuk ka një vendim nga Komisioni në lidhje me kërkesën e paraqitur prej subjektit të rivlerësimit për bashkimin e çështjes së tij me atë të rivlerësimit të bashkëshortes, në kushtet kur të dyja këto procese po kryheshin njëkohësisht dhe kishin për objekt të njëjtën pasuri në bashkëpronësi.

4.2. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur sa vijon.

(i) Dy huat, prej 3 milionë lekësh secila, të marra në vitin 2003, para se të emërohej gjyqtar, për blerjen e apartamentit në Vlorë në të njëjtin vit, përkatësisht nga babai dhe daja i bashkëshortes, i provon nëpërmjet deklaratimit në deklaratën fillestare të pasurisë së vitit 2003 dhe nëpërmjet deklaratave noteriale të huadhënësve.

(ii) Mundësia financiare në vitin 2003, e huadhënësit D. H. [babai i personit të lidhur], vërtetohet nëpërmjet gjendjeve në llogaritë bankare, regjistrimit në organet tatimore dhe ushtrimit të aktivitetit si avokat, sikurse rezulton edhe nga vendimet gjyqësore.

(iii) Mundësia financiare e huadhënësit Th. M. [daja i personit të lidhur] në vitin 2003, vërtetohet nga të dhënat e procedimit penal¹ në dëm të tij, me objekt të ardhurat nga kambizmi. Ky procedim penal i ndjekur nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për ngjarje të ndodhura në vitin 2009, si dhe nga publikimet në gazetën “{***}”, në vitin 1998², lidhur me bastisjen/grabitjen e disa kambistëve, përfshin si viktimitë të veprës penale edhe z. Th. M..

(iv) Çmimi i shitjes së apartamentit në Vlorë prej tij dhe bashkëshortes, në vlerën 16.800.000 lekë, në datën 18.12.2011, nuk mund të llogaritet referuar standardeve të Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”), ndërsa rishitja nga blerësi brenda dy muajve nga data e blerjes në një vlerë më të ulët – për çmimin 12.000.000 lekë – ka qenë e nxitur nga rrethana shëndetësore personale të papritura dhe të vlerësuara të rënda në atë kohë.

(v) Në analizën financiare të kryer në Komision për z. D. H. dhe bashkëshorten, për periudhën 2004 – 2010, lidhur me huan prej 42.000 eurosh në vitin 2011, nuk janë llogaritur të ardhurat e z. D. H. nga avokatia për periudhën 2003 – 2006, sikurse nuk është llogaritur mundësia e kursimit të shumës së kthyer prej subjektit të rivlerësimit huadhënësit [1.500.000 lekë], pas shitjes së apartamentit në Vlorë, në datën 18.12.2011. Po për huan, subjekti thekson se ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit deri në shumën prej 42.000 eurosh, pa u shtrirë [detyrimi] në të gjitha pasuritë që z. D. H. kishte pasur.

(vi) Analiza financiare e kryer në Komision për subjektin e rivlerësimit për periudhën 2003 – 2016, është rezultat i moszbatimit të drejtë të detyrave dhe orientimeve të Kolegjit mbi shpenzimet e subjektit të rivlerësimit jashtë shtetit në vitet 2014 dhe 2015. Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim provat mbi qëndrimin e subjektit te të afërmit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada.

4.3. Në datën 13.10.2022, subjekti i rivlerësimit ka sjellë parashtrime dhe tetë (8) prova të reja³. Duke argumentuar se këto prova i janë bërë të njohura vetëm pas shpalljes së vendimit, subjekti i rivlerësimit potencon rëndësinë e këtyre akteve për zgjidhjen e çështjes në kushtet kur ato hedhin dritë mbi ligjshmërinë e të ardhurave të dy huadhënësve. Aktet e sjella rishtazi tregojnë një situatë të ndryshme faktike nga ajo që ka ekzistuar në momentin e dhënies së vendimit prej Komisionit, pretendon subjekti. Duke kërkuar pranimin e tyre në cilësinë e provës nga Kolegji, subjekti i rivlerësimit

¹ *Procedimi penal me nr. {***} i regjistruar në Prokurorinë e Shkallës së Parë Vlorë.*

² *Gazeta {***}, artikulli me titull “Banda me maska bastis kambistët”.*

³ *Aktet e sjella me parashtrimet e datës 13.10.2022, janë: (i) vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, datë 07.06.2022, për pagesat e tatimit, kryer nga z. D. H., për periudhën 1994-2004, në përgjigje të kërkesës së të njëjtës ditë, drejtuar nga bashkëshortja e tij këtij institucioni. Përgjigja shoqërohet me kopje të dokumentacionit të ndodhur në dosjen fizike e që përfshin kërkesën për regjistrim të z. H. në organet tatimore, deklaratën për çelje të veprimtarisë, lejen për ushtrimin e profesionit dhe deklarinimin periodik vjetor; (ii) kthim përgjigjeje, datë 11.04.2022, z. Th. M. nga Ministria e Financave, që përmban informacion mbi veprimet e tij financiare në firmat piramidale, shoqëruar nga kopje të kartelave përkatëse – me të dhëna ku individit kërkues rezultoi me tri kontrata kreditore; (iii) tri dokumente personale të z. Th. M., përfshirë një letër njoftim të vitit 1991, një certifikatë martesë të lëshuar më 21.06.2022 dhe një certifikatë familjare të tij, lëshuar më 10.08.2022.*

përfundimisht, *ndryshe* nga sa kishte kërkuar në ankim, nëpërmjet parashtrimeve, kërkoi: (i) Kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, riçeljen e hetimit administrativ dhe administrimin e provave të reja bashkëngjitur parashtrimeve. (ii) Prishjen e vendimit objekt ankimi të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe urdhërimin e Komisionit që të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit edhe për dy kriteret e tjera.

4.4. Në parashtrime, subjekti thekson se provat e reja përmbushin kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në kushtet kur përgjatë korrespondencës me Komisionin, autoritet tatimore kanë kthyer përgjigje vetëm për të dhëna nga sistemi elektronik, ndonëse kishin të dhëna të regjistruara edhe në formën e dosjes fizike të z. H.. Po ashtu, subjekti solli në vëmendje edhe faktin që periudha kohore që përkon me afatin e tij për ankim, ka përkuar me kohën e mbylljes së gjithë institucioneve dhe kufizimit të lëvizjeve për shkak të pandemisë së Covid-19 [4 mars 2020 deri në 29 maj 2020, afati i fundit për të ushtruar ankim në rastin e tij]. Përpos sa më sipër, subjekti parashtron se, nga korrespondenca zyrtare gjatë hetimit administrativ, ka qenë nën përshtypjen e gabuar se tatimet për biznesin e vogël, përfshirë aktivitetin e avokatisë, kanë qenë administruar nga pushteti vendor. Korrespondenca e Komisionit me këtë të fundit kishte prezantuar një situatë sipas të cilës rezultonte se taksat vendore ishin shlyer.

4.5. Së fundmi, për sa u përket akteve me anën e të cilave kërkon të provojë të ardhurat e ligjshme të mjaftueshme për huadhënien nga z. M., subjekti mbështetet në jurisprudencën e Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit K. Selita në periudhën e ndërmjetme⁴ – pasi është marrë vendimi objekt ankimi i Komisionit – për sa u përket të ardhurave nga firmat piramidale dhe meqenëse pasqyron të ardhura të disponuara në vlera të mjaftueshme nga një person i tretë, për të ardhurat e të cilit subjekti nuk ka qenë në dijeni.

4.6. Po ashtu, në parashtrime, subjekti i rivlerësimit argumenton kundërshtimet e tij ndaj konkluzionit të Komisionit, lidhur me problematikën e konstatuar në shitjen e apartamentit në Vlorë, nën dritën e jurisprudencës së Kolegjit në periudhën pasi është marrë vendimi objekt ankimi. Ndër to, subjekti sjell në vëmendje, në mbështetje të argumenteve të tij, vendimet e Kolegjit në çështjet nr. 21/2020, nr. 33/2021, nr. 22/2022, nr. 14/2021, sikurse edhe çështjet nr. 22/2019 dhe nr. 18/2022, të cilat mbështesin prapësimet e tij që blerësi i apartamentit në Vlorë të mos konsiderohet person tjetër i lidhur në kuptim të përkufizimit të ligjit nr. 84/2016. Nën të njëjtën dritë, atë të jurisprudencës së Kolegjit në periudhën pasi është marrë vendimi objekt ankimi, subjekti i rivlerësimit argumenton kundërshtimet e tij për konkluzionin e Komisionit për një balancë negative në kryerjen e shpenzimeve dhe investimeve me burime të ligjshme, në

⁴ https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/09/Vendimi_Kastriot_Selita_web-2.pdf, (JR) nr. 15/2021.

analizën financiare të kryer nga Komisioni. Për këtë qëllim, subjekti referon pjesë të vendimeve të Kolegjit në çështjet JR nr. 31/2020, nr. 38/2021 dhe nr. 17/2022.

4.7. Argumentet në parashtrime, që fokusohen në të drejtat e subjektit për proces të rregullt, rezultojnë të jenë ato të parashtruara në ankim e lidhen kryesisht me mospranimin e kërkesës së një komisionereje për dorëheqje – shtjelluar në detaj në paragrafin 4.1./ii më sipër.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

5. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, për rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

6. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit⁵, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

7. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në Kolegji, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Përjashtim bëjnë rastet kur trupi gjykues gjen se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 243,

⁵ Vendimi i arsyetuar i Komisionit iu njoftua subjektit të rivlerësimit në datën 14.05.2020. Ndaj vendimit të arsyetuar është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit, protokolluar me nr. {***} prot., dhe pranuar nga Komisioni me vendimin nr. {***}, datë 01.06.2020.

datë 04.03.2020, të Komisionit u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi.

B. Mbi shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

8. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi objekt shqyrtimi është i cenueshëm për disa arsye, e konkretisht: vendimi paraqet probleme për shkak se asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit nuk është gjyqtar, për shkak se njëra nga anëtarët e trupit gjykues të Komisionit, znj. Xhensila Pine, gjendej në kushtet e papajtueshmërisë, meqenëse kishte ndjekur shkollën e mesme dhe të lartë me subjektin, për shkak se Komisioni i ka dërguar atij [subjektit] pyetje në situata të jashtëzakonshme, pa i lënë kohën e mjaftueshme dhe, së fundmi, për shkak se Komisioni nuk kishte marrë vendim për bashkimin e çështjes së tij me atë të rivlerësimit të bashkëshortes, që gjithashtu ishte në proces rivlerësimi.

8.1. Së pari, përkundër pretendimit të subjektit të rivlerësimit se fakti që anëtarët e trupit gjykues nuk janë gjyqtarë, përbën cenim të parimit të *gjykatës së caktuar me ligj*, trupi gjykues i Kolegjit çmon të risjellë në vëmendje, ndër të tjera, sa është konkluduar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”) në çështjen kyç të jurisprudencës së saj, *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*⁶, në konkluzionin se institucionet e krijuara për të kryer rivlerësimin, përmbushin garancitë e sanksionuara nga neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj) për sa i përket gjykatës së krijuar me ligj. Në të njëjtën mënyrë ka konkluduar edhe Kolegji në jurisprudencën e deritanishme⁷ në analizën e pretendimeve të ngjashme nga subjekte të tjera rivlerësimi. Nën dritën e gjithë këtyre arsyetimeve, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se procesi i rivlerësimit të tij nuk është kryer nga një gjykatë e krijuar me ligj, për shkak të faktit që komisionerët nuk vijnë nga radhët e gjyqësorit, është i pabazuar.

8.2. Së dyti, trupi gjykues i Kolegjit çmon që janë të pabazuara edhe argumentet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të procesit të rregullt. Mospranimi i kërkesës së komisioneres Xhensila Pine për përjashtim nga trupi gjykues që mori vendimin objekt shqyrtimi, përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit, nuk nënkupton që ajo ndodhej në kushtet e papajtueshmërisë dhe mungesës së paanësisë. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mban në konsideratë si pretendimet e subjektit të rivlerësimit, ashtu edhe aktet në fashikull. Ndër to, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje disa aspekte të analizuara në vijim.

8.2.i. Së pari, ndryshe nga sa pretendon subjekti, nuk rezulton nga procesverbali i mbajtur nga Komisioni në funksion të vendimmarrjes⁸, që komisionerja Pine të ketë kërkuar

⁶ Paragrafët 280 - 288 të vendimit të GjEDNj-së, *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*.

⁷ Vendimi nr. 19/2022 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, paragrafi 20.

⁸ Vendimi, datë 12.12.2019, i trupit gjykues të Komisionit, shortuar me vendimin nr. {***}, datë 04.12.2019, të Komisionit; pjesë e fashikullit të përcjellë në Kolegj.

përrjashtimin pasi nuk ndjehej e pavarur apo ndjehej e paragjykuar. Përkundrazi, sipas procesverbalit në fashikull, komisionerja në mënyrë të shprehur ka pohuar që nuk ka vënë në dyshim asnjëherë paanshmërinë e saj⁹. Edhe më herët, në datën 23.09.2018, në momentin e shortimit në trupin gjykues, e njëjta komisionere ka deklaruar, në zbatim të rregullores së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit. Qëndrimi i hershëm i komisioneres për mungesë konflikti interesi, qartazi konsistent edhe me atë të vetë subjektit, paraqet rëndësi. Ky qëndrim fillestar tregon që lidhja e vetme e drejtpërdrejtë e komisioneres me subjektin – për shkak të shkollimit në shkollë të mesme dhe të lartë në të njëjtën shkollë e klasë – ishte një fakt i hershëm në kohë, i njohur për vetë komisioneren, sikurse edhe për vetë subjektin, dhe pranuar prej tyre si një i tillë që nuk passjell gjendje konflikti interesi. Edhe në vlerësimin e kryer nga Komisioni, në kërkimet e vetë komisioneres apo edhe në pretendimet e parashtruara nga subjekti, ky fakt nuk përbën në vetvete, i vetëm e në parim, mungesë paanësie. Në këto kushte dhe pas analizës së kryer në Kolegj, trupi gjykues vëren se rrethanat e shkollimit të përbashkët nuk përbëjnë në vetvete gjendje mungese paanësie, si nën dritën e testit objektiv, ashtu edhe të atij subjektiv, të zberthyer nga jurisprudenca e GjEDNj-së¹⁰. Ky qëndrim gjen zbatim edhe në dispozitën që rregullon dorëheqjen¹¹ për anëtarët e organeve kolegjiale, neni 30 i ligjit nr. 44/2015. Kjo dispozitë parashikon 14 rrethana në të cilat anëtari i një organi kolegjial – në rastin konkret, i një trupe gjykuese të Komisionit – duhet të mos marrë pjesë në vendimmarrje. Asnjë prej tyre nuk konsiston në shkollimin e përbashkët me një individ për të cilin merret vendim. Si pasojë, mungesa e rrethanave të parashikuara nga ligji, passjell prezumimin ligjor të paanësisë.

8.2.ii. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se e vetme, rrethana e qenies së subjektit të rivlerësimit me komisioneren në një klasë në gjimnaz dhe në klasë paralele në shkollë të lartë, pa u shoqëruar me rrethana të njohura të miqësisë apo armiqësisë ndërmjet tyre, në kuptim të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016¹², të nenit 30, germa “h” e Kodit të Procedurave Administrative (në vijim “K.Pr.Administrative”) dhe të nenit 5, pika 1, germa “dh”, nënndarja “v” e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të

⁹ Paragrafi i parë i faqes 3 të procesverbalit të mbajtur nga Komisioni më 11.12.2019, për të dokumentuar pyetjet e drejtuara komisioneres Xhensila Pine, lidhur me kërkesën e saj për përrjashtim, depozituar më 04.12.2019.

¹⁰ Piersack kundër Belgjikës (1982) dhe më tej, ndër të tjerë, në Hauschildt kundër Danimarkës (1989).

¹¹ Për rastet kur ligji parashikon detyrimin për mospjesëmarrje në vendimmarrje për të garantuar paanësinë në administratën publike, shih nenin 30 të ligjit nr. 44/2015, ndër të tjera, në: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2018/04/Kodi-i-Procedurave-Administrative.pdf>.

¹² Neni 27 i ligjit nr. 84/2016, parashikon: “1. Anëtari i institucioneve të rivlerësimit deklaroi dhe shmang çdo situatë konflikti interesi, në respektim të ligjit “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit”. Çdo vendim i marrë në një situatë konflikti interesi, përveç pasojave ligjore në procesin e vendimmarrjes, përbën shkelje disiplinore, sipas këtij ligji. 2. Në rast se anëtari i institucioneve të rivlerësimit nuk mund të shqyrtojë një çështje që i është caktuar për shkaqet e përmendura në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative ose të ligjit “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, ai njofton me shkrim menjëherë trupin gjykues. Përrjashtimi i komisionerit, gjyqtarit ose Komisionerit Publik nga shqyrtimi i çështjes vendoset nga një tjetër trup gjykues që caktohet me short. [...]”

interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”)¹³, nuk ngrihet në nivelin e dyshimit të arsyeshëm, objektivisht të justifikueshëm, se nga Komisioni nuk është garantuar paanësia në shqyrtimin e çështjes që i përket subjektit të rivlerësimit.

8.2.iii. Rrethana tjetër, parashtruar nga komisionerja në mbështetje të kërkesës së saj për dorëheqje, e që lidhet me marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, u vlerësua nga trupi gjykues i Kolegjit, e pamjaftueshme për të legjitimuar përjashtimin apo shqetësimin për një konflikt të mundshëm në dukje të interesit. Nga procesverbali i sipërcituar, rezulton se komisionerja Pine ka parashtruar si mbështetje të kërkesës së saj për përjashtim, rrethanat *hipotetike* kur ajo dhe subjekti mund të ndodhen në afërsi të njëri-tjetrit në ambientet e shkollës ku studion vajza e komisioneres, meqenëse bashkëshortja e subjektit punon për institucionin që ka themeluar shkollën. Në vlerësim të trupit gjykues, pretendimi se komisionerja dhe subjekti mund të ndodhen në ambientet e shkollës njëherësh, mbështetur në vlerësim hipotetik, e të passjellë përshtypjen për favorizëm, duket i pabazuar në konceptin e konfliktit në dukje të interesit¹⁴, sikurse edhe në një ushtrim logjik të perceptimit që mund të krijojë qenia rastësore e dy individëve në një ambient të hapur e të aksesueshëm lirisht apo për shkaqe specifike nga publiku i gjerë. Si rrjedhojë, trupi gjykues çmon se në rrethanat *hipotetike* të përshkruara, parimi që drejtësia duhet të duket tekta bëhet, nuk mund të argumentohet që të diktojë edhe pritshmërinë që komisionerja dhe subjekti të mos gjenden *rastësisht* në të njëjtin vend, në të njëjtën kohë. Ky argument merr peshë të veçantë në rrethanat e një vendi të përmasave të Shqipërisë dhe përqendrimit të shtuar të popullsisë dhe shërbimeve kryesore në qytetin e Tiranës, ku funksionon institucioni arsimor në fjalë.

8.2.iv. Arsytimi i Komisionit se rrethanat e parashtruara nga kërkuesja nuk vërtetojnë asnjë pengesë ligjore për ushtrimin e detyrës, është i drejtë, nën dritën e nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative – apo rrethana që të vërtetojnë rrethana personale “apo të çdo lloji qoftë” të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. E. C., dhe komisioneres Xhensila Pine. Sikurse ka konkluduar Komisioni, fakti i punësimit të znj. C. si drejtore juridike pranë {***} [institucioni që ka themeluar shkollën ku studion vajza e komisioneres], nuk përbën në vetvete dhe do të ishte e pamundur të argumentohet se shoqërohet me interesa private të komisioneres. Bashkëshortja e subjektit është punëmarrëse e një personi juridik, institucion i pavarur, i cili, ndër të tjera, ka krijuar dhe menaxhon një shkollë private. Detyrat e bashkëshortes së subjektit, si drejtore juridike, përfshijnë mbarëvajtjen e institucionit dhe mbrojtjen e interesave të tyre ligjorë. Asgjë në

¹³ Neni 5, pika 1, germa “dh”, nënndarja “v” e ligjit nr. 9367/2005, parashikon: “1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: [...] dh) marrëdhënie: [...] v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë”.

¹⁴ Sipas nenit 3, pika 4, germa “b” e ligjit nr. 9367/2005: “[...] “konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësisë të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë [...]”.

përshkrimin e fakteve të parashtruara nga komisionerja, nuk provon përplasjen e interesave të saj dhe të personit të lidhur me të [vajzës] me ato të institucionit ku ajo shkollohet, edhe në nivel teorik. Përkundrazi, në parim, interesat e studentëve dhe të shkollës pritet të jenë në linjë me njëri-tjetrin.

8.2.v. Nën dritën e këtij arsytimi, trupi gjykues vëren se është i drejtë konstatimi i Komisionit se nuk ka vend të argumentohet se marrëdhënia e përshkruar nuk mund të perceptohet si marrëdhënie që përbën kushte serioze njëanshmërie me palët në procedurë, përcaktuar nga germa “g” e nenit 30 të të njëjtit ligj. Ky konkluzion bazohet në arsytimin e mësipërm për mungesë interesash personale të bashkëshortes së subjektit, e cila ka një marrëdhënie të përhershme me shkollën ku arsimohet vajza e komisioneres. Është po ashtu i drejtë konkluzioni i Komisionit se në rrethanat e parashtruara nga komisionerja, mungojnë fakte të cilat mund të interpretohen nga publiku apo subjekti si provë ose indicie e mungesës së objektivitetit apo vlerësim paragjykes e që mund të ndikojë në zgjidhjen e çështjes.

8.2.vi. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit çmon se merr rëndësi të veçantë fakti që subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë pretenduar asnjëherë në ankim, sikurse edhe gjatë procesit në Komision, ndonjë argument ligjor apo rrethanë faktike në prapësim të arsytimit të trupit gjykues të Komisionit që ka vendosur mospranimin e kërkesës së komisioneres. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kërkuar përjashtimin e komisioneres Pine apo identifikuar sjellje të saj, të cilat përbënin konfirmim të ndonjë paragjykimi apo gjendjes së papajtueshmërisë së pretenduar prej tij për herë të parë në ankim. Përkundrazi, pretendimi i subjektit për proces të parregullt të kryer për të, është kryekëput i ngritur mbi kërkesën e vetë komisioneres, të pambështetur prej tij me kërkesë të vetën, që gjithsesi, sipas tij, duhet të ishin pranuar nga Komisioni.

8.2.vii. Rezulton se Komisioni e ka shqyrtuar kërkesën e komisioneres, në përputhje me garantitë kushtetuese për proces të rregullt, duke shortuar një trup tjetër gjykues për këtë qëllim, ka analizuar në mënyrë shteruese bazën ligjore që rregullon mënjanimin e konfliktit të interesit dhe rrethanat faktike të shtjelluara prej komisioneres pasi edhe e ka dëgjuar atë, edhe ka disponuar me vendimin përkatës. Për rrjedhojë, si dhe duke abstraguuar nga mungesa e argumenteve të subjektit pse komisionerja ishte në kushtet e papajtueshmërisë në rrethanat konkrete faktike e ligjore, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të parimeve të procesit të rregullt për shkak të pranisë së komisioneres Pine, është i pabazuar. Për rrjedhojë, pjesëmarrja e kësaj komisionereje në trupin gjykues të Komisionit që ka shqyrtuar çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, nuk ka cenuar garantimin e paanësisë.

- 9.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk i ka lënë kohë të mjaftueshme për kthimin e përgjigjeve, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, sipas rastit, duke i caktuar afat, por edhe pa afat të caktuar. Trupit gjykues të Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur edhe dokumente në funksion të shqyrtimit të çështjes, në afatet e caktuara prej Komisionit, por edhe jashtë këtyre afateve.

9.1. Kështu, në përgjigje të pyetësorit të datës 24.09.2019, për një pyetje lidhur me mundësinë financiare të z. E. K., me afat 7 ditë, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime, shoqëruar me dokumente, përtej këtij afati – tetë (8) ditë më vonë, në datën 09.10.2019 – me *e-mail*, në datën 22.10.2019, dorazi dhe gjithashtu dorazi në datën 25.10.2019¹⁵. Nuk rezulton po ashtu që subjekti i rivlerësimit të ketë kërkuar kohë shtesë, e që kjo kërkesë të jetë refuzuar nga Komisioni. Për herë të parë, subjekti rezulton ta ketë ngritur këtë pretendim në ankim.

9.2. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka arritur të japë shpjegime, ka paraqitur dokumente të cilat Komisioni i ka pranuar e përfshirë edhe përtej afatit të paracaktuar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjektit të rivlerësimit i janë respektuar edhe garancitë procedurale për proces kontradiktor në hetimin administrativ, në zbatim të nenit 47 të ligjit nr. 84/2016¹⁶ dhe nenit 47 të K.Pr.Administrative¹⁷. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk është cenuar në të drejtën e tij për të dhënë mendime dhe shpjegime.

10. Subjekti i rivlerësimit, më tej, ka argumentuar se përbën shkelje të të drejtave të tij procedurale fakti që Komisioni nuk ka marrë një vendim në vijim të kërkesës për bashkimin e çështjes së tij me atë të bashkëshortes, gjithashtu subjekt rivlerësimi. Nga analiza e akteve në fashikull dhe dispozitave ligjore që zbatohen, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Ky konkluzion është rezultat i analizës që shtjellohet në vijim.

10.1. Së pari, nga aktet në fashikull, rezulton se Komisioni ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për bashkimin e çështjeve në një gjykim të vetëm, me vendimin nr. {***}, datë 28.01.2019. Pavarësisht argumenteve të subjektit të rivlerësimit që bazohen mbi faktin se pasuria e tij dhe ajo e bashkëshortes është e përbashkët dhe në raport të barabartë, dy çështjet respektive janë konsideruar procese të ndryshme nga Komisioni. Ndonëse nuk rezultojnë akte që të provojnë se këtë vendim Komisioni t'ia ketë njoftuar subjektit të rivlerësimit, në vlerësim të trupit gjykues të Kolegjit, kjo mungesë komunikimi nuk mund të argumentohet se është e një peshe të atillë që ka përbërë cenim të të drejtave procedurale. Në kushtet kur nga vijimi i procesit është bërë e qartë që çështjet nuk do të bashkoheshin dhe, mbi të gjitha, nën dritën e faktit që garancitë procedurale për proces të rregullt nuk kushtëzohen nga bashkimi i çështjeve të tyre me çështje të tjera, qofshin këto të lidhura ngushtë në tërësi apo pjesërisht, ky

¹⁵ Subjekti ka shpjeguar vonesën në marrjen e informacionit dhe të dokumentacionit si pasojë e faktit që z. K. fillimisht ka qenë jashtë Shqipërisë e më pas ka qenë në kushte pamundësie objektive, pasi një anëtar i afërt i familjes [babai i bashkëshortes] ka ndërruar jetë më 30 shtator 2019.

¹⁶ Neni 47 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit rregullohen sipas përcaktimeve të neneve 35 - 40 dhe neneve 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative”.

¹⁷ Neni 47 i K.Pr.Administrative parashikon: “Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes”.

pretendim i subjektit duket i pakuptimtë. Garancitë procedurale, si dhe ato për një gjykim objektiv e të bazuar në fakte e ligj, lidhen ngushtë me mënyrën se si gjykata zgjidh secilën çështje e zbaton në proces, garancitë e secilës palë për gjykim të drejtë. Kjo është edhe arsyeja përse në të dyja dispozitat e ligjit, të cituara nga vetë subjekti në ankim, konkretisht neni 24 i ligjit nr. 49/2012 dhe neni 57, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, bashkimi ose gjykimi veçmas mbetet diskrecion i gjykatës, siç rezulton qartë nga një lexim i thjeshtë i tyre¹⁸.

10.2. Nën dritën e sa më sipër, në çështje të mëparshme që përfshinin kontrollin e kriterit të pasurive të krijuara nga magjistratët bashkëshortë, Kolegji ka theksuar se procesi i rivlerësimit të secilit bashkëshort është autonom dhe i pavarur nga i tjetrit, pavarësisht lidhjes që mund të ketë në vlerësimin e pasurisë¹⁹.

10.3. Përpos sa më sipër, lidhja e ndërsjellë mes çështjeve, për shkak të kontrollit të pasurive të bashkëshortëve subjekte rivlerësimi, nuk zgjidh dy kriteret e tjera të rivlerësimit, për të cilat secili subjekt duhet të vlerësohet në mënyrë autonome e t'i nënshtrohet një hetimi të pavarur e objektiv. Për pasojë, edhe në një qasje në nivel konkret të çështjeve praktike të shtruara për zgjidhje, trupi gjykues i Kolegjit çmon se bashkësia e pasurive të krijuara nga bashkëshortët, nuk rezulton të jetë element i mjaftueshëm për t'i bërë proceset përkatëse të varura nga njëra-tjetra. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i drejtë vendimi i Komisionit për mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për bashkimin e çështjes së tij me atë të bashkëshortes. Pavarësisht, nga dështimi për t'ia njoftuar këtë vendim subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, në pikën fundore, pasojat e vendimit nr. 2, datë 28.01.2019, qoftë edhe nëse do t'u ishte njoftuar dy subjekteve, do të ishin të njëjta.

10.4. Së fundmi, në kushtet kur vendimi i Komisionit iu nënshtroa kontrollit të kryer nga Kolegji nëpërmjet ankimit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, ky aspekt i shkaqeve të ankimit shërohet nëpërmjet analizës së mësipërme dhe e bën të panevojshëm zbatimin e përcaktimeve të nenit 51, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 49/2012²⁰, për korrigjim të shkeljeve procedurale në seancë publike në prani të subjektit.

¹⁸ Neni 24 i ligjit nr. 49/2012, për bashkimin e padive në gjykimin administrativ, parashikon: "[...] Kur në një gjykatë janë duke u shqyrtuar padi, në të cilat marrin pjesë po ata persona, si paditës ose si të paditur, ose padi që kanë lidhje midis tyre, gjykata **mund** t'i bashkojë këto në një gjykim dhe të japë për të gjitha një vendim të përbashkët". Neni 57 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: "1. Kur dy ose më shumë padi janë duke u gjykuar në procese të ndryshme dhe lidhen midis tyre për nga objekti ose shkaku, **mund** të bashkohen në një gjykim të vetëm [...]".

¹⁹ Vendimi nr. 20/2019 që i përket subjektit të rivlerësimit G. Osmani, vendimi nr. 20/2022, paragrafi 12.2, që i përket subjektit të rivlerësimit E. Lluri.

²⁰ Neni 51, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 49/2012 parashikon: "1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: [...] b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale [...]".

11. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit i gjen të pambështetura pretendimet e subjektit të rivlerësimit se vendimi objekt shqyrtimi është i cenueshëm, për shkak të shkeljeve të rënda të ligjit procedural.

C. Mbi shkaqet e ankimit për vlerësimin e pasurisë

12. Vendimi i Komisionit për masën disiplinore të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit, është fokusuar kryesisht në burimet e krijimit të një pasurie të paluajtshme [apartament, me vendndodhje në Vlorë], shitja e së cilës është deklaruar si burim krijimi i apartamentit në Tiranë, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, përkundër mundësisë së kryerjes së shpenzimeve dhe kursimeve me burime të ligjshme. Në këtë kontekst, Komisioni ka arritur përfundimet e referuara më sipër, në paragrafët 3.1 – 3.3. Po ashtu, edhe shkaqet e ankimit për sa i përket themelit të vendimit, fokusohen në këto tri aspekte të vendimit. Analiza e detajuar e këtyre aspekteve dhe konkluzionet e trupit gjykues të Kolegjit shtjellohen në vijim.

C.I. *Apartamenti në Vlorë*

13. Rezulton se në deklaratën *vetting*, si burim krijimi për apartamentin në Tiranë në vitin 2012, në vlerën 155.000 euro²¹, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën prej 113.000 eurosh, të përfutur nga shitja e apartamentit në qytetin e Vlorës në vitin 2011, dhe huan prej 42.000 eurosh nga vjehri, z. D. H.. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë [apartament banimi] në qytetin e Vlorës në vitin 2003. Po ashtu, Komisioni ka argumentuar, ndër të tjera, se subjekti i rivlerësimit *mund të ndodhet në kushtet e pamundësisë* për të provuar në këtë kohë pagimin e tatimit përkatës, për shkak të problemeve të mosruajtjes nga sistemi, si dhe për faktin se z. D. H. ka ndërruar jetë, vështirësi që, sipas Komisionit, mund të kapërcehej nëse së paku do të provohej regjistrimi i tij pranë organeve tatimore përkatëse. Komisioni ka vlerësuar se gjendja e fondeve në bankë në emër të z. H., nuk provon se të ardhurat janë të ligjshme. Sipas Komisionit, të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit privat të avokatit nuk do të ishin të mjaftueshme për dhënien e huas dhe aftësia për të kursyer e z. D. H. dhe bashkëshortes deri në vitin 2003, pa përfshirë të ardhurat nga avokatia, ka qenë në vlerën 634.664 lekë.

13.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit duke argumentuar se dy huat për blerjen e apartamentit në Vlorë janë marrë në vitin 2003, përpara se ai dhe bashkëshortja të emëroheshin në detyrë, dhe provohen nga deklarata

²¹ Apartamenti ndodhet në qendër të Tiranës, në rr. “{***}” dhe ka sipërfaqe 147,80 m²; deklaruar i fituar me kontratën noteriale të shitjes me rezervë, që mban datën 22.12.2011 dhe atë përfundimtare të shitjes, që mban datën 01.10.2012.

fillestare e pasurisë për vitin 2003, sikurse edhe nga deklaratat noteriale të huadhënësve. Mundësia financiare e huadhënësit, z. D. H., vërtetohet nga llogaritë bankare, regjistrimi në organet tatimore dhe ushtrimi i aktivitetit si avokat. Për këtë qëllim, subjekti ka përcjellë 108 vendime gjyqësore. Mundësia financiare e huadhënësit tjetër, z. Th. M., vërtetohet nga procedimi penal²² në të cilin ai është viktimë e veprës penale për ngjarje të ndodhura në vitin 2009, e i cili ka për objekt të ardhurat nga kambizmi. Të ardhurat vërtetohen po ashtu edhe nëse merret në konsideratë artikulli i botuar në gazetën “{***}”, në vitin 1998, lidhur me bastisjen/grabitjen e disa kambistëve, një ndër të cilët ishte edhe z. Th. M..

13.2. Përkundër konkluzioneve për sa u përket të ardhurave të huadhënësit tjetër, vjehrrit të tij, subjekti i rivlerësimit argumenton se deri në vitin 2004, në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank, prindërit e bashkëshortes dispononin vlerën 11.850.524 lekë, dhe jo 6.529.297 lekë, siç ka përlllogaritur Komisioni. Sipas subjektit të rivlerësimit, z. D. H., ka qenë i regjistruar në administratën tatimore edhe para vitit 2003, në kushtet kur paguante edhe sigurimet shoqërore si person fizik për periudhën 1999 - 2004. Është *fakt i njohur botërisht*, sipas subjektit të rivlerësimit, se z. H. ka qenë avokat në qytetin ku banoi dhe në kushtet kur ishte pjesë e kryesisë së Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Angazhimi i konsiderueshëm i vjehrrit, sipas subjektit të rivlerësimit, provohet nga vendimet gjyqësore të sjella si provë nga ana e subjektit – për rreth 122 prej tyre. Sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka të dhëna në institucione për sa i përket shlyerjes së detyrimeve në tatime e, për rrjedhojë, gjejnë zbatim kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

13.3. Në parashtrimet e dërguara në datën 13.10.2022 dhe në tetë (8) aktet e sjella në cilësinë e provës [shtjelluar më sipër në paragrafët 4.3 deri në 4.5, ndër të tjera], subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se këto akte paraqesin rëndësi për zgjidhjen e çështjes në kushtet kur hedhin dritë mbi ligjshmërinë e të ardhurave të dy huadhënësve dhe se ka ardhur në dijeni të tyre vetëm pas shpalljes së vendimit.

13.4. Pasi i analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrimet në Kolegj, përmbledhur më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë e të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë plotësisht ligjshmërinë e burimeve të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurisë. Edhe nëse për mundësinë financiare të huadhënies nga personi tjetër i lidhur, z. D. H., merren në konsideratë të ardhura si pasojë e akteve të reja nga administrata tatimore në Vlorë, cituar më sipër, përcjellë Kolegjit nga subjekti i rivlerësimit në datën 13.10.2022,²³, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimeve që kanë shërbyer për huan tjetër të deklaruar si burim për këtë pasuri. Analiza e këtyre fakteve shtjellohet në vijim.

²² *Procedimi penal me nr. {***}, i regjistruar në Prokurorinë e Shkallës së Parë Vlorë.*

²³ *Përmbledhur më sipër, në paragrafin 4.3 dhe poshtëshënimin nr. 3.*

C.1. Lidhur me huat e deklaruara nga z. D. H. dhe z. Th. M.

14. Nga një analizë kronologjike e të dhënave që rezultojnë nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur ndër vite dhe nga hetimi administrativ në Komision, trupi gjykues i Kolegjit konstaton sa vijon.

a. Në deklaratën periodike vjetore të parë, për vitin 2003, mungon deklarimi për datën e kryerjes së pagesës për blerjen e apartamentit në Vlorë, sikurse edhe dokumentacioni provues. Për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë, të specifikuar si *borxhi familjar*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar tri hua në vlerën totale prej 7.000.000 lekësh, marrë te të afërmit, përkatësisht nga: a) vjehri, z. D. H., shuma prej 3.000.000 lekësh; b) daja i bashkëshortes, z. Th. M., shuma prej 3.000.000 lekësh; dhe c) i ati, z. Ll. C., shuma prej 1.000.000 lekësh. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar të dhëna për huadhënësit, përveç adresave të tyre. Te secila nga huat, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se arsyeja e krijimit të detyrimit, ka qenë “kredi banese.”

b. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar se kontrata e huas nuk ka *numër dhe datë* dhe që huat ishin *pa afat dhe pa interes*. Në seksionin e detyrimeve, subjekti i deklarimit ka specifikuar *shlyerjet* vjetore dhe për herë të parë, *emrat e huadhënësve*. Në vijim, në deklaratat periodike vjetore të periudhës kohore deri në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar shlyerjet dhe detyrimin e mbetur, për secilën hua.

c. Duke filluar nga deklarata periodike për vitin 2005 e deri në vitin 2010, ky apartament është deklaruar si adresë banimi, ndërsa blerja është deklaruar në deklaratën periodike/vjetore 2008.

ç. Sipas kontratës së shitjes, datë 27.10.2008, me shoqërinë “{***}” ShPK, çmimi i apartamentit është referuar 6.000.000 lekë. I pyetur në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se diferenca prej 1.000.000 lekësh, ishte përdorur për mobilimin e apartamentit. Shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, nëpërmjet shkresës, datë 22.11.2019, ka informuar Komisionin se apartamenti ishte ndërtuar në periudhën korrik 2003 – mars 2005 dhe pagesat ishin kryer në arkën e shoqërisë gjatë periudhës së ndërtimit, ndërsa kontrata e shitblerjes u formalizua në datën 27.10.2008, pasi u kolaudua objekti.

14.1. Nëpërmjet deklaratës noteriale, datë 24.09.2019, huadhënësi, z. Th. M., ka deklaruar se në vitin 2003, i ka dhënë huan prej 3.000.000 lekësh, mbesës së tij, znj. E. C. [bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit], dhe subjektit të rivlerësimit, me qëllim blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës. Huaja është dorëzuar pa kontratë, është dhënë pa interes dhe pa mandat. Sipas huadhënësit, huaja është shlyer *cash*, pa mandate dhe pa kontratë, përkatësisht: a) në vitin 2004, shuma prej 1.900.000 lekësh; b) në vitin 2005, shuma prej 800.000 lekësh; dhe c) në vitin 2006, shuma prej 300.000 lekësh.

Nga dokumentacioni në fashikullin e Komisionit²⁴, rezulton që provohet ushtrimi i aktivitetit nga z. D. H. për vitet 1998-2003, por mungojnë të dhëna zyrtare të cilat do të provonin nivelin e të ardhurave dhe, për rrjedhojë, një përlllogaritje në funksion të përcaktimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Nga shkresat e lexuara në harmoni, rezulton se fitimi nga veprimtaria si avokat e z. H., për vitet 2010-2015, sipas tri shkresave nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, respektivisht për secilin vit referohet: 155.158 lekë, (-) 37.087 lekë, (-) 11.127 lekë, (-) 26.982 lekë, 51.126 lekë dhe 1.626 lekë. Pavarësisht disa mospërputhjeve, në aktet e administruara nga Komisioni dhe ILDKPKI-ja është referuar se regjistrimi pranë administratës tatimore, sikurse edhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, daton duke filluar vetëm nga 27.03.2003, që nënkupton një periudhë kohore disaveqare pas asaj të argumentuar nga subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të mundësisë së huadhënësit për të kontribuar me burime të ligjshme për huan e dhënë atij dhe bashkëshortes. Vendimi objekt ankimi është bazuar në këto të dhëna për të ardhurat e personit tjetër të lidhur.

14.2. Pasi është njohur me përgjigjen dhe aktet e përcjella nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë në datën 07.06.2022, si pasojë e kërkesës së vjehrrës së tij për dokumentacion dërguar në të njëjtën ditë, subjekti ka paraqitur prova të zbuluara rishtazi, të cilat janë përmbledhur më sipër [në paragrafin 4.3 dhe në poshtëshënimin korrespondues]. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe nëse do të ishin pranuar këto akte në cilësinë e provës, faktet që ato provonin nuk do të ndikonin në marrjen e vendimit. Me fjalë të tjera, duke pranuar që subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012,

²⁴ Në fashikullin e Komisionit janë administruar 10 akte, lidhur me këtë aspekt të hetimit administrativ: (i) kopje e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë 20.7.1998, për regjistrimin e personit tjetër të lidhur, z. D. H., si person fizik, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë private në fushën e avokatisë; (ii) vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Vlorë [datë 18.10.2016], që konfirmon sigurimet shoqërore të z. H., si person fizik për periudhën 16.2.1999 – 31.12.2004, si dhe dokumentacion lidhur me pensionin e përfutur prej tij më tej; (iii) vërtetim nga Bashkia Vlorë [datë 17.10.2016], që konfirmon se subjekti tregtar në emër të personit tjetër të lidhur, ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifën prej vitit 1998 deri në datën e çregjistrimit, 20.4.2015, në QKR; (iv) vërtetim [nr. {***} prot.], datë 12.10.2016, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, dërguar ILDKPKI-së, sipas të cilit z. D. H., figuron i regjistruar si person fizik në datën 27.3.2003, me veprimtari “aktivitete juridike”, dhe deri në datën që ka aplikuar për çregjistrim [21.4.2015], i ka paguar të gjitha detyrimet tatimore; (v) tri vërtetime nga Bashkia Vlorë [nr. {***} prot.], datë 2.10.2019, [nr. {***} prot.], datë 1.11.2019 dhe [nr. {***} prot.] datë 14.11.2019, sipas të cilave referohet se për “subjektin tregtar “{***}”, për periudhën 1999 – 2006, nuk disponohen të dhëna në regjistrin e tatimpaguesve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore”, ndërkohë që citohen xhirot e vlerësuar dhe taksat e paguara për vitet 2007-2009. Në vërtetimin e fundit, Bashkia Vlorë referon se për periudhën 1999 – 2006, nuk disponohen të dhëna në regjistrin e tatimpaguesve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore për asnjë tatimpagues. (vi) Shkresë, [nr. {***} prot.] datë 18.02.2019, nga Qendra Kombëtare e Biznesit, që referon se z. H. figuron të jetë regjistruar si person fizik më datë 27.3.2003; (vii) tri shkresa nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, drejtuar Komisionit [datë 12.02.2018] dhe dy të tjera [datë 17.8.2017, nr. {***} prot., dhe datë 30.6.2017, nr. {***} prot.], drejtuar ILDKPKI-së. Sipas tyre, ndër të tjera, konfirmohet se personi tjetër i lidhur është regjistruar si person fizik në datën 27.3.2003, me veprimtari “aktivitete juridike” dhe është regjistruar nga regjistrat e administratës tatimore në datën 21.04.2015. Ndryshimi i vetëm mes tri shkresave konsiston në mospërputhje sa i përket shlyerjes së detyrimeve tatimore.

meqenëse nuk kishte qenë në gjendje të parashtronte këto dokumente më herët, jo për faj të tij²⁵, në analizën tërësore të të gjitha aspekteve ligjore, për shkak të problematikave të tjera të shtjelluara në vijim, zgjidhja përfundimtare do të mbetet e njëjtë. Nga leximi harmonik i këtyre akteve, rezulton se institucionet publike konfirmojnë që personi tjetër i lidhur, z. D. H., është regjistruar pranë këtij institucioni me vendim gjykate në datën 20.07.1998 dhe ka shlyer rregullisht pagesat e tatimeve në periudhën kohore nga viti 1999 – 2004. Bazuar në qarkullimin e mundshëm që rezulton nga përlllogaritja e tatimeve të konfirmuara nga DRT Vlorë për këtë periudhë, nëse përlllogaritet fitimi maksimal i mundshëm i realizuar nga personi tjetër i lidhur deri në datën 31.12.2003, personi i lidhur ka mundësi financiare për dhënien e huas prej 3.000.000 lekësh për subjektin e rivlerësimit, sipas analizës së thjeshtë të të ardhurave minus shpenzimet bazike të jetesës²⁶.

14.3. Nga ana tjetër, për sa u përket likuiditeteve në bankë, argumentuar nga subjekti i rivlerësimit si provë e mundësisë financiare të prindërve të personit të lidhur me të për të dhënë huan, nga analiza e kryer në Kolegj rezulton se balanca e likuiditeteve në bankë në emër të bashkëshortëve H., e përlllogaritur nga Komisioni në vlerën prej 6.529.297 lekësh²⁷, është e saktë. Si rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka kryer një përlllogaritje të gabuar të vlerave monetare në bankë të personit tjetër të lidhur, është i pabazuar. Vlera e pretenduar nga subjekti për gjendje në llogari bankare, në shumën [totale] prej 11.850.524 lekësh, do të qëndronte vetëm nëse të tria depozitat bankare do të ishin njëkohësisht aktive në momentin e mbylljes së njëres prej tyre. Nga konfirmimi i Raiffeisen Bank, rezulton se depozita e tretë është çelur pasi janë mbyllur dy të parat, çka nuk e përjashton faktin se depozita e tretë mund të jetë formuar me fondet e depozitave të mbyllura.

14.4. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se aktet e reja të sjella nga subjekti i rivlerësimit, ndonëse provojnë vazhdimësinë e ushtrimit të aktivitetit privat të personit tjetër të lidhur, e arrijnë të konfirmojnë mundësinë financiare të z. H. për dhënien e huas, në vlerësimin tërësor, nuk do të kishin ndikim në drejtim të “shërimit” të pozitës së subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë shkak ankimi.

²⁵ Neni 47 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” përcakton se: “[...] Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

²⁶ Në analizën e kryer në Kolegj, shpenzimet e jetesës janë konsideruar në masën 30% të të ardhurave nga pagat për periudhën 1993 – 1999, si dhe sipas standardit të referuar ILDKPKI-së nga INSTAT-i për periudhën 2000-2003.

²⁷ Nga verifikimi i konfirmimeve bankare deri në datën 31.12.2003, trupit gjykues të Kolegjit i rezultoi e njëjta balancë, konkretisht: a) në BKT, shuma prej 900.000 lekësh; dhe b) në Raiffeisen Bank, shuma prej 5.629.297 lekësh.

C.3. Lidhur me ligjshmërinë e burimit të huas nga z. Th. M. në vitin 2003

15. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur, për dhënien e kësaj huaje dhe as burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua. Sipas Komisionit, ushtrimi i veprimtarisë së kambizmit nuk nënkupton automatikisht gjenerim të ardhurash të mjaftueshme për të dhënë huan. Po ashtu, Komisioni ka gjetur se mungojnë të dhënat për qarkullimin apo fitimin e krijuar nga personi tjetër i lidhur nga ky aktivitet.

15.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se huadhënësi, z. Th. M., kishte burime të ligjshme nëpërmjet të ardhurave të siguruara nga aktiviteti i kambizmit. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti paraqiti si prova materialet e procedimit penal të regjistruar në vitin 2017, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për ngjarje të ndodhura në vitin 2009²⁸, dhe publikimet në gazetën “{***}”, të datës 04.08.1998²⁹. Sipas subjektit të rivlerësimit, z. Th. M., ka qenë kambist i lirë dhe nuk ka pasur detyrimin të deklarojë të ardhura në vitet ‘90.

15.2. Nga analiza e akteve të sipërcituara, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ndonëse angazhimi i personit tjetër të lidhur në aktivitet këmbimi valutash të huaja rezulton rrethanë faktike bindëse, dokumentacioni i mbledhur e administruar në hetimin administrativ, sikurse edhe ai i sjellë nga subjekti i rivlerësimit, nuk arrijnë në nivelin që të lejojnë kryerjen e një analize financiare në kuadër të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit, për sa i përket vlerës së fondeve që huadhënësi mund të kontribuonte apo ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre. Nga ana tjetër, aktet e sjella rishtazi nga subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet e datës 13.10.2022 [përmbledhur në poshtëshënimin nr. 3], u gjetën të panevojshme dhe pa ndikim në marrjen e vendimit, nën dritën e kërkesave të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49, pika 6 dhe germet “a” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016 dhe, si rrjedhojë, nuk u pranuan nga trupi gjykues i Kolegjit. Në këtë arsyetim, trupi gjykues vëren kohën e gjatë që ka kaluar mes tërheqjes së vlerave financiare nga ish-firmat piramidale e deri në kohën e huadhënies, mungesën e dokumentacionit që tregon që këto fonde kanë qenë të disponueshme gjatë harkut kohor të ndërmjetëm, apo ndryshime të vlerës ndër vite, në shtesë apo pakësim, sipas rastit. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që z. Th. M., për herë të parë është regjistruar si tatimpagues për ushtrimin e veprimtarisë si kambist në vitin 2008, pesë (5) vite pas huas së deklaruar në vitin 2003, subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, të ardhurat e pretenduara të gjeneruara nga ky aktivitet përpara dhe në mungesë të licencimit, edhe nëse do të pranoheshin të mirëqena, do të dështonin të kalonin testin e ligjshmërisë, përcaktuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë dhe në përmbledhje të sa më sipër, gjithë

²⁸ *Procedim penal lidhur me një hua në vlerën 35 mijë euro, dhënë nga z. M. në vitin 2009, dy individëve [nr. {***}] i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë].*

²⁹ *Sipas artikullit, nga denoncimet e bëra në policinë lokale, kambistit Th. M. i ishin grabitur 60.000.000 lireta [italiane] nga një grup njerëzish me maska.*

aspektet e rrethanave faktike të cilat iu nënshtruan analizës ligjore të kryer në Kolegj, nuk sjellin si konkluzion logjik konstatimin e mjaftueshmërisë apo të ligjshmërisë së burimeve të huadhënësit nën dritën e nenit 32, pika 4.

15.3. Për rrjedhojë, nën dritën e kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstatoi që subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësinë e krijimit të të ardhurave me burime të ligjshme nga huadhënësi Th. M., në vlerën prej 3.000.000 lekësh.

C.4. Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Vlorë në vitin 2011

16. Burim tjetër i krijimit të pasurisë objekt analize, është deklaruar vlera e përfitur nga shitja e apartamentit në Vlorë [analizuar si më sipër], në vlerën prej 16.800.000 lekësh, një të afërmi të subjektit të rivlerësimit, z. E. K., më datë 18.12.2011³⁰. Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, për fiktivitet në lidhje me këtë transaksion, duke theksuar se nuk ka gjurmë dokumentare të transferimit të shumës prej 16.800.000 lekësh nga z. E. K., te subjekti i rivlerësimit në vitin 2011 apo sesi ky i fundit ka transferuar në Shqipëri të ardhurat e përfituara në Itali. Në këtë vlerësim, Komisioni ka pasur në konsideratë edhe që gjendet bankare të z. K. nuk provojnë disponimin e kësaj shume në vitin 2011. Nga ana tjetër, të ardhurat e dokumentuara të z. E. K., për periudhën 1999 – 2011, janë në vlerën 1.872.119 lekë, gjë që nuk provon mundësitë e tij financiare për blerjen e apartamentit. Komisioni ka vlerësuar se çmimi i shitjes së apartamentit, në vlerën 16.800.000 lekë, nuk është çmimi real, pasi: (i) është dy herë më i lartë sesa çmimi i referencës për qytetin e Vlorës në vitin 2011, sipas udhëzimit të Entit Kombëtar të Banesave; (ii) dy muaj pas shitjes nga subjekti i rivlerësimit, kushëririt të tij, në datën 28.2.2012, blerësi/kushëriri e ka rishitur të njëjtin apartament për një vlerë prej 4.800.000 lekësh *më pak* sesa e bleu [në vlerën 12.000.000]; dhe (iii) me të ardhura të dokumentuara, të z. E. K., për periudhën 1999 – 2011, nuk provohet mundësia e tij financiare për blerjen e apartamentit.

16.1. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton vlerësimin e Komisionit, duke argumentuar ligjshmërinë e transaksionit sipas dispozitave të kohës. Në kontratën e shitjes është përcaktuar shkëmbimi i shumës jashtë zyrës noteriale. Çmimi i shitjes nuk mund të llogaritet referuar standardeve të EKB-së, pretendon subjekti, pasi *nuk ka lidhje me realitetin e çmimeve* në shitblerjen e tregut të lirë duke qenë *jashtëzakonisht më i ulët* se realiteti. Referuar edhe tek akti i rivlerësimit, datë 25.11.2011, apartamenti është në gjendje shumë të mirë dhe në pozicion shumë të favorshëm, argumenton ai. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti ka referuar dy kontrata porosie dhe një kontratë shitjeje në qytetin e Vlorës, që datojnë në të njëjtën periudhë kohore të shitjes së apartamentit nga subjekti i rivlerësimit. Për sa përket rishitjes brenda dy muajve nga z. E.

³⁰ Kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.12.2011.

K., subjekti i rivlerësimit parashtron se ka qenë e nxitur nga rrethana shëndetësore të papritura dhe të vlerësuara të rënda në atë kohë të kushëririt.

16.2. Subjekti i rivlerësimit po ashtu ka kundërshtuar vendimin e Komisionit edhe për kontrollin e ligjshmërisë së burimeve të z. K., duke theksuar që nën dritën e kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, kontrolli i ligjshmërisë së burimeve të të ardhurave të blerësit, z. K., është në tejkallim të barrës së provës që duhet të mbajë ai sipas ligjit. Në mbështetje të pretendimeve të tij për rrethanat faktike që kanë përbërë kontekstin e rishitjes së apartamentit, apo të situatës financiare e shëndetësore të z. K., subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime në Komision. Në fashikull gjenden edhe aktet e depozituara për këtë aspekt të rezultateve të hetimit nga subjekti³¹.

16.3. Në parashtrimet e datës 13.10.2022, në mbështetje të argumenteve të tij të shtjelluara më sipër, për këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka referuar për vëmendjen e trupit gjykues të Kolegjit, një sërë vendimesh të marra nga vetë Kolegji³².

16.4. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për këtë transaksion, është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit ka kryer transaksion fiktiv për vlerën e shitjes së apartamentit, për të justifikuar burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e apartamentit në Tiranë. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në vijim.

16.5. Nga fashikujt e përcjellë nga Komisioni, rezulton se apartamenti në Tiranë – siç referohet në paragrafin 13 më sipër dhe poshtëshënimin nr. 21 – është blerë me kontratën noteriale të shitjes me rezervë, që mban datën 22.12.2011, dhe atë përfundimtare të shitjes, që mban datën 01.10.2012, me vlerë 155.000 euro. Si burim krijimi, ka shërbyer edhe shitja e apartamentit në Vlorë, në vlerën e 113.000 eurove, ose ekuivalenti i 16.800.000 lekëve. Këto transaksione janë deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse dhe në deklaratën e pasurisë, në funksion të rivlerësimit [deklaratën *vetting*]. Nga aktet në fashikull, rezulton se apartamenti në Vlorë është rivlerësuar në vlerën 16.800.000 lekë³³ në datën 01.12.2011 dhe i është shitur z. K. 17 ditë më pas, me kontratën e shitblerjes së sipërcituar. Z. E. K. ia ka shitur një individ të tretë të njëjtin apartament, dy muaj më pas, në shkurt 2012, për 12.000.000 lekë, që domethënë me një

³¹ Subjekti ka depozituar në Komision disa akte të lëshuara nga Spitali Amerikan, konkretisht: përgjigje të dy ekzaminimeve mjekësore dhe konsultë për pacientin E. K., datë 07.02.2012. Me këto akte, subjekti mbështet pretendimet e tij për rrethanat faktike që kanë përbërë kontekstin e rishitjes së apartamentit, në kushtet kur dyshohej se blerësi E. K. vuante nga një sëmundje e rëndë.

³² Vendimet e referuara nga subjekti me parashtrimet, janë si vijon: vendimi nr. 21/ 2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Roland Jaupaj; nr. 33/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Ndini Tavani; nr. 22/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi; nr. 14/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irma Balli; nr. 15/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita; nr. 22/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Bujar Hoti; nr. 18/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Banushi dhe nr. 3/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Malo Orhani.

³³ Shkresa nr. [***], datë 22.10.2019, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, dërguar Komisionit.

humbje prej 4,8 milionë lekësh [ekuivalenti i rreth 34.400 eurove me kursin e këmbimit të kohës], krahasuar me blerjen.

16.6. Subjekti i rivlerësimit pretendon se z. K., në periudhën 1999 – 2011, ka provuar me dokumentacion të ardhurat prej 153.396 eurosh. Në faqet 13 dhe 14 të vendimit, Komisioni ka pasqyruar një analizë të detajuar të dokumentacionit të sjellë nga subjekti i rivlerësimit për të ardhurat e z. K., e ka konkluduar mungesë burimesh për të përballuar blerjen e apartamentit. Komisioni i ka përllogaritur të ardhurat e z. E. K., për periudhën 1999 – 2011, në vlerën 1.872.119 lekë. Në vendim, mungon një shpjegim se cilat të ardhura janë marrë në konsideratë për të arritur në këtë shifër.

16.7. Në analizën e kryer në Kolegj, konfirmohet e njëjta situatë faktike, sipas së cilës të ardhurat e ligjshme të dokumentuara të z. K., janë konsiderueshëm më të ulëta sesa vlera prej rreth 120.000 eurosh që do të ishte ekuivalenti i çmimit të blerjes së apartamentit. Aktet e përcjella në fashikullin e Komisionit, provojnë të ardhura në vlerën *maksimale* të mundshme prej 30.610 eurosh. Nëse nga kjo vlerë do të zbriteshin shpenzimet e jetesës, balanca negative kundrejt vlerës 120.000 euro [ekuivalenti i çmimit të apartamentit prej 16.800.000 lekësh] do të thellohej më tej. Në përllogaritjen e kryer në Kolegj, u përfshinë në vlera të plota të ardhurat e dokumentuara plotësisht, si dhe, të ardhurat e dokumentuara sipas konfirmave bankare³⁴. Të ardhurat e pretenduara nga puna si kamerier, sikurse edhe nga njëri prej punësimeve³⁵, duke mos kapërcyer kriterin ligjor për provueshmërinë apo ligjshmërinë e të ardhurave, nuk u përfshinë në të ardhurat e provuara.

16.8. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni i ka kaluar një barrë prove në tejkalim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të ardhurat e z. K., nuk është i bazuar. Komisioni nuk e ka kategorizuar këtë individ si person tjetër të lidhur. Pamundësia financiare e z. K. është një ndër aspektet e analizuar nga Komisioni në kuadër të besueshmërisë së transaksionit financiar të blerjes së apartamentit nga subjekti. Në kushtet e rishitjes së të njëjtës pasuri brenda disa javëve me humbje të konsiderueshme, Komisioni rezulton se ka analizuar mundësitë financiare të z. K. njëkohësisht me aspektet e tjera të transaksionit, që paraqesin një panoramë fiktiviteti,

³⁴ Në këtë kategori u përfshinë të ardhurat nga bursa në vitet 2006-2007, në vlerën 6.451 euro, nga {***}; të ardhurat nga dëmshpërblimi, në vlerën 4.000 euro, sipas check-ut bankar me datë 23.07.2007, në emër të z. E. K. nga {***}, pjesë e dokumenteve të dërguara nga avokatja E. P.; sikurse edhe të ardhurat nga {***}, sipas korrespondencës me e-mail nga z. M. Z., i cili ka dërguar fotokopje të disa dokumenteve që konfirmojë marrëdhënien e punës, si: kopje të deklarimit të marrëdhënies së punësimit tek INPS, kopje të deklaratave mujore të përllogaritjes së pagës neto të lëshuar nga punëdhënësi, z. M. Z., në total 4853 euro. Po ashtu, në përllogaritje, u përfshinë të ardhurat sipas konfirmave bankare nga {***} [vërtetim, datë 13.01.2011, sipas të cilit z. E. K. ka qenë i punësuar part-time pranë këtij universiteti si menaxher IT, për periudhën janar - dhjetor 2010, dhe paga e tij **neto** ka qenë 700 euro/muaj.] Nga llogaria e z. K. pranë "Alpha Bank", evidentohet se në llogari janë kredituar pagesa vetëm për tre muaj prej **405 eurosh/muaj**; së fundmi në këtë kategori, u përfshinë të ardhurat nga Tirana Leasing, sipas konfirmës bankare në Tirana Bank, në vlerën 1.219.825 lekë, dhe të ardhurat neto nga {***}, për të cilat, nga vlera 9.728 euro është paguar kontributi prej 2.404,76 eurosh.

³⁵ Përgjigje me e-mail nga përfaqësues i {***}.

sikurse marrëdhënia e afërt mes subjektit të rivlerësimit dhe blerësit, mungesa e gjurmëve dokumentare të këtij transaksioni apo mungesa e fondeve në dispozicion të blerësit, të cilat mund të ishin argumentuar se kanë shërbyer për blerjen. Në të njëjtin kuadër, është vlerësuar çmimi relativisht i lartë, krahasuar me atë të referencës dhe atë të shitjes në vijim një individ të tretë.

16.9. Me fjalë të tjera, të gjitha këto aspekte rezultojnë të kenë qenë pjesë e një analize gjithëpërfshirëse të Komisionit, në drejtim të plotësimit të një panorame të plotë të veprimeve të kryera nga subjekti në fund të vitit 2011, si rezultat i të cilave është krijuar pasuria në vlerën 155.000 euro në Tiranë, nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në dhjetor 2011³⁶. Në kushtet kur të ardhurat që kanë shërbyer si burim për këtë pasuri të deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, në vlerën që përbën përreth 72% të vlerës së apartamentit, janë krijuar nga shitja e një apartamenti në Vlorë, vlera e të cilit tetë (8) vjet pas blerjes, është rritur me 10.800.000 lekë ose 2,8 herë, për të pësuar ulje të konsiderueshme në vlerë prej thajse 1/3 e saj [4.800.000 lekë më pak në shkurt 2012], brenda pak javësh, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar analizën e kryer nga Komisioni. Veprimet e kryera nga subjekti në funksion të transaksionit të shitjes paraqiten fiktive dhe kanë për qëllim të justifikojnë me burime të ligjshme krijimin e pasurisë në Tiranë, në rrugën “{***}”. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi që subjekti i rivlerësimit nuk provoi vërtetësinë e çmimit të deklaruar të transaksionit financiar, në shumën prej 16.800.000 lekësh.

C.5. Analiza financiare për vitet 2003-2016

17. Komisioni ka konstatuar se nga analiza financiare për periudhën e rivlerësimit, subjekti rezulton me një balancë negative në shumën (-) 879.551 lekë, për të kryer shpenzimet dhe pasuritë e deklaruara. Në këtë vlerë nuk janë përfshirë gjetjet e analizuar më sipër për apartamentin në Tiranë dhe krijimin e asaj pasurie ndër vite. Sipas vendimit, ky bilanc negativ është ai i rezultuar pasi Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, pasi i ka kaluar barra e provës³⁷. Në analizën përfundimtare të Komisionit, pasqyruar në faqen 25 të vendimit, balancat negative rezultojnë për periudhën kohore që përfshin vitet 2012-2016.

17.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo vlerë negative vjen si rezultat i moszbatimit të drejtë të detyrave dhe orientimeve të Kolegjit mbi shpenzimet e subjektit të rivlerësimit jashtë shtetit, në vitet 2014 dhe 2015, pasi Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura prej tij që provojnë qëndrimin të afërmit në ShBA dhe Kanada. Në parashtrimet e paraqitura më 13.10.2022, subjekti nuk ka ngritur pretendime të reja, por thekson se e ka ezauruar barrën e provës me paraqitjen e adresave të afërmeve

³⁶ Shtjelluar edhe më sipër, në paragrafin 13 dhe poshtëshënimin nr. 21.

³⁷ Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisionit i ka rezultuar një balancë negative në vlerën (-) 1.829.708 lekë.

ku ka qëndruar dhe që kjo vlerë negative nuk duhet të përbëjë shkak për marrjen e masës së shkarkimit nga detyra, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, referuar vendimeve të Kolegjit për disa subjekte të tjera rivlerësimi³⁸.

17.2. Në konsideratë të akteve në fashikull dhe pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, pasi ia nënshtroi kontrollit analizën financiare të kryer nga Komisioni, për gjithë periudhën kohore 2012-2016 – vite në të cilat kanë rezultuar balancat negative objekt ankimi – trupi gjykues i Kolegjit gjen të konfirmuar balancën negative të konstatuar nga Komisioni. Në vijim të konstatimeve të shtjelluara më sipër për kontrollin e kriterit të pasurisë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për të ndryshuar masën disiplinore të shkarkimit, në zbatim të parimit të proporcionalitetit, për shkak të një balance negative në këtë vlerë, rrjedhimisht nuk gjendet i bazuar.

17.3. Në analizën e kryer në Kolegj, u krye llogaritja e shpenzimeve të udhëtimit sipas metodologjisë së përcaktuar në Kolegj [duke trajtuar pretendimet e subjektit për qëndrimin te të afërmit³⁹ në ShBA dhe Kanada në vitet 2014 dhe 2015], dhe gjithashtu u krye verifikimi i të gjithë zërave të tjerë. Në zbatim të parimit të mospërkeqësimit të situatës së subjektit të rivlerësimit pas ankimit, trupi gjykues konfirmon balancën negative të pasqyruar në vendimin e Komisionit. Nga ana tjetër, nëse Komisioni do të kishte zbatuar standardet e zhvilluara nëpërmjet jurisprudencës së Kolegjit, kur subjektet kanë pretenduar mbulim shpenzimesh nga pritësit gjatë udhëtimit jashtë shtetit, rezultati financiar negativ do të ishte më i thelluar. Nga dokumentacioni i administruar, për llogaritja e shpenzimeve gjatë qëndrimit te të afërmit në Kanada, pranuar nga Komisioni sipas deklaramit të subjektit, është bazuar vetëm mbi një deklaratë nga të afërmit e tij me anë të një *email*-i, pa dokumentacion që konfirmon vendqëndrimin e pritësve në vendet përkatëse në periudhën kohore në fjalë⁴⁰. Konkretisht, në rast se Komisioni do të kishte ndjekur orientimin nga jurisprudenca e Kolegjit, rezultati financiar negativ i gjithë periudhës në fjalë do të ishte (-) 905.585 lekë.

17.4. Pavarësisht nga vlera negative që përftohet mbi bazën e korigjimeve në Kolegj, sa më sipër, në rrethanat faktike konkrete, analiza financiare e viteve të analizuara dhe për

³⁸ Konkretisht, subjekti ka referuar vendimin e Kolegjit me nr. 31/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Elvin Gokaj; vendimin nr. 38/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male Ziguri; si dhe vendimin nr. 17/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Marinela Osmani Nuni.

³⁹ Për të provuar qëndrimin te të afërmit në ShBA dhe Kanada, subjekti ka depozituar në Komision: (i) Kopje të noterizuar të printimeve të komunikimeve elektronike me dy individë, për të provuar qëndrimin në ShBA. Ndër të tjera, deklaruesit shprehën se kanë pritur familjen Civici dhe kanë përballuar të gjitha shpenzimet e tyre. (ii) Kopje të noterizuar të printimeve të komunikimeve elektronike me A. dhe A. V. mbi qëndrimin në Kanada. Nëpërmjet këtyre komunikimeve, ndër të tjera, A. V. deklaroi se ka mirëpritur familjen Civici dhe ka përballuar të gjitha shpenzimet e tyre, për shkak se ka pasur mundësi financiare, duke qenë se në vitin 2015 zotëronte dy biznese private: “{***}” dhe “{***}”, kurse bashkëshortja është e punësuar në {***} pranë {***} Toronto Airport.

⁴⁰ Për më tepër, për dokumentacionin e kërkuar nga Kolegji për të provuar deklaramit të kësaj natyre, shih, ndër të tjera, vendimin nr. 11/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit E. Islamaj, ose vendimin nr. 27/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit D. Peka.

të cilat subjekti ka ngritur pretendime në ankim, për shkak të problematikave të tjera serioze në formën e mungesës së burimeve të ligjshme për të dhënë huat dhe të fiktivitetit në transaksionin e shitjes së pasurisë së paluajtshme, shtjelluar në detaj më sipër, nuk ka vend të zbatohet parimi i proporcionalitetit për balancën negative të arsyetuar.

18. Së fundmi, një pjesë e argumenteve të subjektit në ankim, fokusohet kundër mendimit paralel të vëzhguesit ndërkombëtar që shoqëron vendimin objekt shqyrtimi⁴¹. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të panevojshme, nën dritën e parimit të efikasitetit [ekonomisë gjyqësore], të ndalet në këtë aspekt të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, nën dritën e parashikimeve të nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 5, pika 2 e të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilëve, objekt shqyrtimi janë vendimet e Komisionit për të cilët është ushtruar ankim. Në kushtet kur mendimi paralel i vëzhguesit, lidhur me dhurimin e 42.000 eurove nga personi tjetër i lidhur [z. H., vjehri i subjektit të rivlerësimit], nuk ka passjellë asnjë veprim procedural që do t'i nënshtrohet kontrollit rishikues të Kolegjit, konkluzioni i Komisionit për pranimin si të mirëqenë të mundësisë së krijimit të këtyre fondeve nga personi tjetër i lidhur, konsiderohet se ka mbetur në fuqi.
19. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
20. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe parashtrime dhe shqyrtoi provat shkresore të administruara në fashikujt e përcjellë nga Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit Andi Civici nuk ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të pasurisë, parashikuar në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, dhe gjendet në kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
21. Për pasojë, vendimi nr. 243, datë 04.03.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁴¹ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/05/Opinion-i-Vezhguesit-Nderkombetar.pdf>.

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 243, datë 04.03.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Andi Civici.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 17.01.2023.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi